

UDHËZIM
Nr.46, datë 13.11.2009

PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE PËR KONFISKIMIN, MAGAZINIMIN DHE SHKATËRRIMIN E MJETEVE TË LOJËRAVE TË FATIT

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në zbatim të pikës b të nenit 51 të ligjit nr.10 033, datë 11.12.2008 “Për lojërat e fatit”, Ministri i Financave

UDHËZON:

1. Konfiskimi i mjeteve të lojërave të fatit kryhet nga sektori i masave shtrënguese ose nga inspektorët e tjerë të NJMLF-së me urdhër nga titullari i NJMLF-së. Inspektorët që kryejnë konfiskimin e mjeteve plotësojnë aktkonfiskimin, në të cilin përcaktohen qartë:

- a) të dhënat e sakta për subjektin që i kryhet konfiskimi;
- b) vendndodhja e saktë e pikave ku kryhet konfiskimi;
- c) numri i mjeteve të lojërave të fatit të konfiskuara;
- d) lloji, tipi, si dhe numrat serialë të këtyre mjeteve (nëse këto mjete i posedojnë).

2. Mjetet e lojërave të fatit të konfiskuara, në prezencë të gjithë grupit të konfiskimit, brenda jo më shumë se 48 orëve në rastet e ekzistencës së një arsyeje objektive, magazinohen në magazinën e NJMLF-së. Në momentin e magazinimit pritet fletëhyrje, një kopje e së cilës i bashkëlidhet aktit të konfiskimit. Kjo fletëhyrje pritet nga magazinieri ose në mungesë të tij nga një punonjës i ngarkuar nga titullari i NJMLF-së.

3. Përgjegjësi i grupit që ka kryer konfiskimin, menjëherë pas mbarimit të procesit të magazinimit, përpilon raportin përfundimtar të detajuar për të gjitha detyrat e ngarkuara në urdhrin e konfiskimit.

Kopja origjinale e aktit të konfiskimit dhe kopja e fletëhyrjes në magazinë, i bashkëlidhen raportit përfundimtar.

Raporti nënshkruhet nga të gjithë inspektorët e grupit të konfiskimit dhe pasi miratohet nga titullari, depozitohet në arkivë.

4. Të gjitha mjetet e konfiskuara: të lojërave të fatit si makina elektronike dhe aparaturat e bingos, brenda jo më shumë se 60 ditëve nga dita e sekuestrimit, i nënshtrohen procedurës së shkatërrimit.

Mjetet e tjera të konfiskuara, kompjutera (PC) dhe printera, do të mbahen në magazinën e NJMLF-së derisa të transferohen me urdhër të Ministrit të Financave.

5. Titullari i NJMLF-së ngre një komision përgjegjës për shkatërrimin e mjeteve të lojërave të fatit të konfiskuara. Ky komision ka në përbërjen e tij kryetarin dhe katër anëtarë, përkatësisht nga:

- | | |
|--|----------------|
| a) Njësia e Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit | kryetar; |
| b) Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve | anëtar (një); |
| c) NJMLF | anëtarë (tre). |

6. Ky komision, sipas afateve të përcaktuara në pikën 4 të këtij udhëzimi, kryen inventarizimin (numërimin) e mjeteve për shkatërrim dhe harton procesverbalin e shkatërrimit, ku evidentohen shkatërrimet e kryera sipas llojeve, tipave, numrave serialë. Një kopje e procesverbalit lihet në magazinë dhe një kopje i bashkëlidhet urdhrin e arkivohet në NJMLF.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCEVE
Ridvan Bode